

SHKODËR, ALBANIA  
10 YEARS OF ART HOUSE

20

13.09–13.10

15

•(AB) ABI SHEHU •(AF) ALKET FRASHËRI •(AR) ALKETA RAMAJ •(BF) BIB FRROKAJ •(BB) BORA BABOÇI  
•(DK) DORUNTINA KASTRATI •(EL) EDSON LULI •(EM) ELSAMINA MUSIO •(EG) ELTON GLLAVA  
•(EM) ERDIOLA KANDA MUSTAJ •(EV) ERGYS VELA •(EZ) ERJOLA ZHUKA •(FD) FATLUM DOÇI •(HC)  
HAVEIT COLLECTIVE •(IL) IVA LULASHI •(JI) JETMIR IDRIZI •(JK) JONA KRASNIQI •(JV) JOZEFINA VOKRRI  
•(LP) LAURA PAJA •(LMG) LEK M. GJELOSHI •(LL) LORI LAKO •(LC) LUKA CVETKOVICH •(MS) MARINA SULA  
•(MD) MARLIN DEDAJ •(NM) NAZLI MORIPEK •(NB) NORA BZHETA •(OK) ORESTIA KAPIDANI  
•(RP) REMIJON PRONJA •(SB) SAMELA BALAZI •(ST) SAŠA TATIĆ •(SA) SILVA AGOSTINI  
•(SR) STEFANO ROMANO •(XM) XHULIAN MILLAJ

20

HOMeward

25

ART HOUSE / CIVIC GALLERY OF SHKODRA  
MARUBI NATIONAL MUSEUM OF PHOTOGRAPHY  
OLD PACI HOUSE / RADIO SHKODRA / FRANCISCAN AUDITORIUM

# A SYMBOLIC JOURNEY TOWARDS HOME

# HOMEWARD

(kuratorë) **Luçjan Bedeni**

**Tea Paci**

**Zef Paci**

**Niovi Zarampouka-Chatzimanou**

*Homeward* e merr titullin nga një udhëtim simbolik drejt shtëpisë, një topos i përbashkët kujtese dhe identitetesh që pulsojnë energji. Shtëpia këtu nuk është domosdoshmërisht një vend i caktuar, por një ndjesi përkatësie, një lëvizje e formësuar nga institucione dhe individë që krijojnë, bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë ide mbi të qenurit artist në ditët e sotme. Ekspozita shpaloset si një yjësi, ku identitetet dhe kujtimet mbruhën më shumë nga marrëdhëniet sesa nga hapësirat.

*Homeward* hapet nën shenjën e artit për dhjetë vjetorin e Art House, një angazhim për ndërtimin e një komuniteti ku artistët, profesionistët e artit dhe komuniteti vendas rriten së bashku përmes të mësuarit, mbështetjes dhe shkëmbimit. E themeluar si një gjest bujarie për komunitetin vendas, Art House mishëron angazhimin e qëndrueshëm të familjes Paci me artin bashkëkohor dhe diskursin artistik, përmes bashkëjetesës hibride të private me publikun. Kjo ekspozitë fton në reflektim mbi dhjetë vjet rritjeje të përbashkët, ndërsa imagjinojnë të ardhmen e Art House si një organizëm që gjallon brenda komunitetit vendas.

*Homeward* reflekton gjithashtu kthimin jo thjesht në një vend, por edhe në një frymë krijimi të përbashkët. Tridhjetë e tre artistë bashkohen si një ansambël polifonik. Veprat e tyre rezonojnë me çështje të identitetit, dashurisë, historisë, kufijve, drejtësisë klimatike dhe dhunës në familje, të shënuara nga flukset e diasporës dhe përvojat në ndryshim të emigrimit dhe të shtëpisë. Këta zëra manifestohen përmes një shumësie mediumesh si piktura, performanca, instalacioni, skulptura dhe imazhet në lëvizje.

Artistët pjesëmarrës kanë qenë pjesë e komunitetit vendas përgjatë katër edicioneve të rezidencës Art House School, një nga programet kryesore të Fondacionit për fuqizimin e artistëve të rinj nga rajoni. Programi ndër vite ka ofruar një model alternativ shkollimi, jo si një transferim vertikal dijes nga mësuesi te nxënësi, por si një shkëmbim përvojash, reflektimesh dhe praktikash midis pjesëmarrësve. Me këtë rast, artistët rikthehen të gjithë së bashku në Shkodër, duke sjellë me vete zgjedhjet, rrugëtimet dhe përvojat e mbledhura që prej atëherë. Krahas tyre, ekspozita nderon kujtimin e një të ftuari të veçantë që është njëkohësisht edhe mikpritësi i saj: Ferdinand Paci (1940–1975). Vizatimet e artistit lidhin të kaluarën dhe të tashmen, duke kujtuar ndarjen e tij nga jeta pesëdhjetë vjet më parë. Prania e tij shfaq një marrëdhënie prekëse midis brezave, duke ndërlidhur kujtesën, trashëgiminë dhe vijimësinë.

Në përputhje me përkushtimin e Art House ndaj sinergjive lokale dhe vetë qytetit, ekspozita i hapet qendrës së qytetit, përmes hapësirave private dhe publike, laike dhe fetare. Nga shtëpia e saj, në Art House, ajo shtrihet në Auditorin Françeskan, Muzeun Kombëtar të Fotografisë “Marubi” dhe Galeria e Arteve të Shkodrës, bashkëpunëtorë të afërt të këtyre viteve. Me këtë rast, një hapësirë e re i ofrohet qytetit: ndërtesa e Radio Shkodrës, e shndërruar për herë të parë në një hapësirë ekspozuese e cila mirëpret një ekspozitë me rëndësi historike për artin shqiptar.

*Homeward* është një udhëtim drejt rrënjëve të asaj që vuri gjithçka në lëvizje. Dhe ja ku jemi përsëri me të njëjtën frymë angazhimi, por më të ditur dhe më të pasur, falë të gjithë atyre që kanë kontribuar ndër vite, duke bashkë-krijuar trashëgiminë e saj. Por, a mund t'i imagjinojmë tani dhjetë vitet e ardhshme? Ndoshta jo tërësisht, por sigurisht që po.

# HOMEWARD

(curators) Luçjan Bedeni

Tea Paci

Zef Paci

Niovi Zarampouka-Chatzimanou

Taking its title from a symbolic journey towards home, *Homeward* is a shared topos of memory, identities, a state of energy. Home here is not necessarily a fixed place but the sense of belonging, a movement shaped by institutions and individuals who create, collaborate, and exchange ideas about art and the condition of being an artist in today's world. The exhibition unfolds as a constellation, where identities and memories glow in relation rather than in place.

Marking the tenth anniversary of the Art House, *Homeward* celebrates a decade-long commitment to building a community where artists, arts professionals, and local citizens grow together through learning, support, and exchange. Founded as a gesture of return to their local community, the Art House embodies the Paci family's enduring engagement with contemporary art and artistic discourse, through the hybrid co-existence of the private with the public. This exhibition invites reflection on ten years of shared growth while imagining the future of the Art House as a living organism within the community of Shkoder.

*Homeward* also reflects on a return not only to a place but to a spirit of shared creation. Thirty-three artists come together as a polyphonic ensemble, their works resonating with questions of identity, love, history, borders, climate justice, and domestic violence, marked by diasporic paths and the shifting experiences of migration and home. These voices are manifested through a wide range of practices spanning painting, performance, installation, sculpture, and moving image.

The participating artists have been integral in this vivid community through the Art House School residency across its four editions; one of the foundation's core programs dedicated to empowering emerging artists from the region. These schools offered an alternative model of learning, not as a vertical transfer of knowledge from teacher to student, but as a circular exchange of experience, reflection, and practice among peers. Today, the artists return together, bringing with them the choices, paths, and experiences gathered since. Alongside them, the exhibition honors a special guest and, at the same time, the true host: Ferdinand Paci (1940–1975). His drawings bridge past and present, recalling his passing fifty years ago. His presence offers a poignant connection across generations, linking memory, legacy, and continuity.

In keeping with the Art House's dedication to local synergies and city engagement, the exhibition unfolds across the city center in five private and public, secular and religious venues. From its original home at the Art House, it extends to the Franciscan Auditorium, the Marubi National Museum of Photography and the Civic Gallery of Shkodër, longstanding partners of the institution. On this occasion, a new space opens to the city: the Radio Shkodra building, is transformed into a cultural venue and a living historical exhibit for the first time.

*Homeward* is a journey of returning to the roots of what first set everything in motion. And now here we are again with the same spirit of engagement, yet wiser and richer thanks to everyone who has contributed throughout it, co-creating its legacy. Can we now imagine the next ten years? Perhaps not entirely, but certainly, yes.

## 1 ART HOUSE

Alketa Ramaj  
Bora Baboçi  
Fatlum Doçi  
Nazli Moripek  
Samela Balazi

## 2 CIVIC GALLERY OF SHKODRA

Alket Frashëri  
Bib Frrokaj  
Doruntina Kastrati  
Elsamina Musiq  
Ergys Vela  
Erjola Zhuka  
Iva Lulashi  
Jona Krasniqi

Jozefina Vokrrri  
Laura Paja  
Lori Lako  
Marina Sula  
Nora Bzheta  
Saša Tatić  
Xhulian Millaj

**Homazh i veçantë / Special homage**  
Ferdinand Paci (1940–1975)

## 3 MARUBI NATIONAL MUSEUM OF PHOTOGRAPHY

Elton Gllava  
Erdiola Kanda Mustafaj  
Jetmir Idrizi  
Orestia Kapidani  
Silva Agostini  
Stefano Romano

## 4 OLD PACI HOUSE

Remijon Pronja

## 5 FRANCISCAN AUDITORIUM

Edson Luli

## 6 RADIO SHKODRA

Abi Shehu  
Haveit Collective  
Lek M. Gjeshi  
Luka Cvetkovich  
Marlin Dedaj





# ART HOUSE

# ALKETA RAMAJ

**Raw drawings  
2021-2024**

Në këtë seri të re punësh, Alketa Ramaj i qaset vizatimit si një metodë e çmësimit, zhbërjes dhe zbrazjes. Praktika e saj poetike dhe intuitive eksploron gjuhët e proceseve të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme, ndërsa angazhohet në aktin e jashtëm të krijimit. Në qendër të punës së artistes është transformimi nga një gjendje në tjetrën, një hetim i vazhdueshëm se si perceptimi ndryshon dhe riformësohet. Vizatimi, për Ramaj, është një akt i menjëhershëm: një vizë e vazhdueshme që lëviz pa pushim, duke i bërë jehonë përshkrimit të Paul Klee në Librin Pedagogjik, të “një vize aktive në ecje, që lëviz lirshëm, pa ndonjë qëllim. Një ecje për hir të vetë ecjes”. Megjithatë, ky spontanitet shfaqet vetëm pas ushtrimeve të gjata vëzhgimi, meditimi dhe soditjeje, që ndonjëherë zgjasin javë ose muaj. Në këto momente, mendimet dhe emocionet e ndrydhura nxisin impulsin për të vizatuar. Pyetja që udhëheq krijimtarinë e Ramaj mbetet: “Çfarë formash të shprehjes vizuale mund të përçohen nga përvoja ime me të pavetëdijshmen, në një mënyrë të singertë dhe të padukshme?” (Bazuar në tekstin e Alketa Ramaj dhe Clara Herrmann)

With this new body of work, Alketa Ramaj approaches drawing as a method of unlearning, undoing, and emptying out. Her poetic and intuitive practice explores the languages of both conscious and unconscious processes, while engaging with the external act of creation. Central to her work is the transformation from one state to another, an ongoing inquiry into how perception shifts and reshapes itself. Drawing, for Ramaj, is an immediate act: a continuous line moving without pause, echoing Paul Klee's description in the Pedagogical Sketchbook of “an active line on a walk, moving freely, without goal. A walk for a walk's sake.” Yet this spontaneity emerges only after long exercises of observation, meditation, and contemplation, sometimes lasting weeks or months. In these moments, compressed thoughts and emotions spark the impulse to draw. Ramaj's guiding question remains: “What forms of visual expression can be conveyed by my own experience of subconscious states of mind, in a way genuine and unobtrusive enough?” (Based on the text by Alketa Ramaj and Clara Herrmann)

# BORA BABOÇI

**The Horizontal Wall  
2023**

“The Horizontal Wall” na kujton arkitekturat e impianteve për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit. Mes bollëkut të ujit nga njëra anë dhe mungesës së tij nga ana tjetër, artistja krijon harkun narrativ të një kopshti të lëngshëm, një peizazh ku bredhin figura mitike. Historitë e tyre të fluturimit dhe të reflektimit narcizist, shpalosen kundrejt një horizonti vertikal të ujit që bie, midis kërcënimit të një vendi të ngurtësuar dhe premtimit të rritjes së bimësisë së harlisur.  
(Fragment nga një tekst i Mihnea Mircan)

“The Horizontal Wall” draws upon architectures of water facilities built for its collection and distribution. Between the abundance of water in one and its scarcity in the other, the artist creates the narrative arc of a liquid garden, a landscape roamed by mythical double figures whose stories of flight and narcissistic reflection unfold against a vertical horizon of water falling, between the threat of a petrified place and the promise of luxuriant vegetal growth.  
(Excerpt from text by Mihnea Mircan)

# FATLUM DOÇI

**F1**  
**2023-2025**

Vepra e merr titullin nga termi bujqësor “hibrid F1”, i cili i referohet gjeneratës së parë të bimëve të krijuara nga kryqëzimi i dy varieteteve mëmë. Këto forma skulpturale pasqyrojnë idenë e përzierjes - ku struktura, rritja dhe harmonia bashkohen në mënyra të reja dhe të ekuilibruara. Të frymëzuara nga modelet e natyrës dhe mundësitë e formës, veprat ftojnë në reflektim mbi krijimin, transformimin dhe sistemet e padukshme që formësojnë jetën.

F1 draws its name from the agricultural term “F1 hybrid,” which refers to the first generation of plants created by crossing two stable parent varieties. These sculptural forms reflect that idea of blending — where structure, growth, and harmony come together in new and balanced ways. Inspired by the patterns of nature and the possibilities of form, the works invite reflection on creation, transformation, and the unseen systems that shape life.

# NAZLI MORIPEK

**At the Core of the Web of Things  
2025**

“At the Core of the Web of Things” është një film dokumentar i shkurtër që eksploron dimensionet simbolike dhe shoqërore të qilimeve anatoliane. Vepra zhvillohet përmes bisedave me individë, marrëdhënia e të cilëve me objektin, buron nga mjeshtëria, trashëgimia familjare, angazhimi artistik ose praktikatat lokale të koleksionimit. Nga këto dialogje burojnë tregime fragmentare mbi mbrojtjen, përdorimin e përditshëm dhe kuptimet e koduara. Çka del në pah është një strukturë polifonike ku njohuritë mbi tekstilet ndërthuren me kontekste shoqërore dhe ekologjike. Një vëmendje e posaçme i kushtohet paraqitjes së kafshëve dhe rolit të tyre në besytnitë e pjellorisë dhe mbrojtjes. Qilimet nuk prezantohen si objekte dekorative, por si bartës të kujtesës kulturore, përvojës së jetuar dhe lidhjes së thellë me botën natyrore.

“At the Core of the Web of Things” is a short documentary film that explores the symbolic and social dimensions of Anatolian kilims. The work unfolds through conversations with individuals whose relationships to kilims stem from craft, family heritage, artistic engagement, or local collecting practices. These dialogues give rise to fragmentary narratives about protection, daily use, and encoded meanings. What emerges is a polyphonic structure in which textile-based knowledge intersects with social and ecological contexts. Special attention is given to animal representations and their roles in ideas of fertility and protection. Kilims are not presented as decorative objects, but as carriers of cultural memory, lived experience, and a deeply rooted connection to the natural world.

# SAMELA BALAZI

## We Used to Be More Sensitive 2025

“Dikur, ishim më të ndjeshëm” zhvillohet si një eksplorim i kujtesës, trupit dhe hapësirës. Punuar me letër të veshur me argjilë dhe laps, vepra ndjek gjurmët e imëta që lënë shenjat e prekjes, gjestet dhe lëvizjet që mbeten, edhe kur nuk janë më të dukshme. Ajo e trajton shtëpinë jo si një strukturë statike, por si një vazhdimësi, një hapësirë përmes së cilës identiteti dhe përkatësia rishqyrtohen. Shtresat hiqen, duke zbuluar atë që mbetet: fragmente të ndjeshmërisë së mëparshme, momente intimiteti me veten dhe botën që janë zbehur, por ende rezonojnë. Mungesa bëhet një formë pranije; çarja shndërrohet në gjurmë. Materialiteti — i brishtë, taktil, i pabarabartë — mbart këtë tension, duke na kujtuar çfarë është humbur, çfarë vazhdon, dhe si trupi arkivon këto nuanca me kalimin e kohës. Në punën e Balazit, domesticiteti, personaliteti dhe truporja bashkohen, duke prodhuar një reflektim të qetë e të qëndrueshëm, të mënyrës se si e banojmë dhe e kujtojmë veten.

“We Used to Be More Sensitive” unfolds as a site-specific exploration of memory, body, and space. Crafted in paper clay and pencil, the work traces the subtle imprints left behind—marks of touch, gestures, and movement that linger even when they are no longer visible. It approaches home not as a static structure but as a continuum, a space through which identity and belonging are reconsidered. Layers are peeled back, revealing what remains: fragments of former sensitivity, moments of intimacy with the self and the world that have faded yet still resonate. Absence becomes a form of presence; fracture becomes a trace. The materiality – fragile, tactile, uneven – carries this tension, reminding us of what is lost, what persists, and how the body archives these subtleties over time. In Balazi’s work, the domestic, the personal, and the corporeal converge, producing a quiet but persistent reflection on how we inhabit and remember ourselves.

# CIVIC GALLERY OF SHKODRA

# ALKET FRASHËRI

## Sentimentality of May Days – The Red Tulip 2022 – 2023

Vepra “Sentimentalizmi i Ditëve të Majit - Tulipani i Kuq”, realizuar ndërmjet viteve 2020 -2023, merr shtysë nga një fotografi shoqërore, arketipi i së cilës mund të haset rëndom (deri në kufijtë e Kitch-it) në shpërfaqjet programatike të masmedias anakënd. Personazhi me trajta femërore në të djathtë të kompozimit, mund të identifikohet sa me staturën e një lidereje parlamentare apo aktivisteje çfarëdo, aq edhe me një kandidate krejt modeste për zgjedhjet lokale, sikurse kanë qenë ato të majit 2015 për Këshillin Bashkiak të qytetit të Shkodrës, të zhvilluara në ambientet e auditorit të Hotel Europa. “Sentimentalizmi i Ditëve të Majit” është titulli i një sërë punimesh, të realizuara që prej vitit 2004. Bëhet fjalë për një entitet veprash në krijimtarinë e artistit, që shërbejnë si katalizatore të takimit të abstraktes me atë që filozofi dhe esteti frëng Michel Henry e quante Realizmi i Madh. Në të ashtuquajturin “sistem pluralist” krejt të brishtë të shoqërisë shqiptare të tranzicionit, politika mbetet ende “mbretëresha” e joshjeve. Sa më epërm gjarpëron shkallarja hierarkike, aq më i dhunshëm bëhet sakaq zhgënjimi kur “mbretëresha” zhvishet nga stolitë e saj dhe magjepsja thyhet. Kjo është edhe arsyeja se përse kjo tablo shpaloset në dy kanavaca asimetrike.

The work “Sentimentality of May Days - The Red Tulip”, created between 2020 and 2023, is inspired by a social photograph whose archetype recurs widely, even to the point of kitsch, in mass media displays. The female figure on the right of the composition may be read as a parliamentary leader, an activist, or a modest candidate in local elections, such as those of May 2015 for Shkodra’s Municipal Council, staged within the auditorium of Hotel Europa. “Sentimentality of May Days” is the title of a series of works by Alket Frashëri developed since 2004. These works serve as catalysts in the meeting of abstraction with what Michel Henry called Great Realism, where allegorical language and historicist references converge regardless of subject. Within Albania’s fragile post-communist pluralism, politics continues to appear as the queen of seductions. Its allure, driven by passion, inevitably dissolves into disillusion, a tension reflected in the two asymmetrical canvases.



# BIB FRROKAJ

**The Project  
2024**

“The Project” është një seri me piktura të bazuara në një histori personale, ku artisti, përmes tablove, përqendrohet në faza specifike të marrëdhënies së tij, duke portretizuar lidhjen, zbulimin dhe dinamikën midis çiftit në një narrativë jo-lineare. Faza e parë nis me të ashtuquajturin “projekt”, i cili më pas shndërrohet në katalizatorin e një lidhjeje intime. Përmes tablove, artisti sjell një analogji mes ndërtimit të një maketi dhe zhvillimit të një marrëdhënieje njerëzore. Format, ngjyrat dhe nuancat përfaqësojnë zanafillën, zhvillimin dhe transformimin e kësaj historie, ku personazhet shfaqen dhe riformësohen si pjesë të një narrative emocionale. Ashtu si në një maket në shkallë të zvogëluar, pikturat shpalosin ndjesitë si dhe transhendencën e formave dhe të materies. Përmes këtij projekti, artisti eksploron kufijtë midis ndijores dhe kujtesës, duke përzier fotografi arkivore me përvoja të jetuara, teksa bën bashkë takimet personale me imazhe dhe kujtime të objekteve ku vepra kërkon të paraqesë një pamje subjektive të momenteve të ndryshme.

“The Project” is a series of Frrokaj’s paintings based on a personal story, where the artist, through the paintings, portrays various stage of his relationship, the discovery and dynamics between the couple in a non-linear narrative. The first phase starts with the so-called “project”, which then becomes the catalyst of an intimate connection. Through the paintings, the artist draws a parallel between the construction of a miniature-scale model and human relationship. The format, colors, and shades represent the origin, development, and transformation of this story, where the characters appear and reshape themselves as part of an emotional narrative. Like a miniature-scale model, the paintings unfold sensations as well as the transcendence of form and matter. Through this project, the artist explores the boundaries between the sensory and memory, blending archival photographs with lived experiences, while bringing together personal encounters with images and memories of objects, where the work seeks to present a subjective view of different moments.

# DORUNTINA KASTRATI

**Silver Bone V**  
**2025**

“Silver Bone V” e Doruntina Kastratit është një skulpturë në formën e një guaske fistiku, që varet nga tavani. E krijuar në printim 3D, sheqer pluhur dhe rripa të bardhë, kjo vepër - pjesë e serisë “Epoka e Kockave të Argjendta” - zbulon një ekonomi të fshehur shfrytëzimi. Vepra kontraston imazhin tërheqës të ëmbëlsirës turke me realitetin e ashpër të punës femërore që e prodhon atë, ku orët e gjata të kaluara në këmbë shpesh çojnë në lëndime e deri në implante të gjurit. Fistiku i varur bëhet një paralajmërim fantazmë dhe sintetik, duke transformuar një arrë të thjeshtë në një simbol të denoncimit shoqëror.

Doruntina Kastrati's Silver Bone V is a sculpture in the shape of a pistachio shell, hanging from the ceiling. Created in 3D-print, sugar powder and white straps, this work—part of the series The Age of Silver Bones—reveals a hidden economy of exploitation. The piece contrasts the appealing image of Turkish delight with the harsh reality of the female labor that produces it, where long hours spent standing often lead to injuries requiring knee implants. The hanging pistachio becomes a ghostly, synthetic warning, transforming a simple nut into a symbol of social denunciation.

# ELSAMINA MUSIQ

**Palimpsest III**  
**2020-2022**

“Palimpsest III” është një reflektim mbi kujtesën dhe mënyrën se si ajo formëson perceptimin tonë për botën. I frymëzuar nga libri “Palimpsest” i Martin Camajt, vepra trajton idenë se kujtimet ndërthuren me kohën, duke krijuar shtresa të reja kuptimi dhe emocioni. Në qendër të saj është një kujtim personal, ku gjyshja e artistes u mësonte fëmijëve të bënin varka letre, për t’i shpërqendruar ata nga dhimbja e vaksinimit. Ky kujtim ndërthuret me ndjenja të tjera, të tilla si marrëdhënia me gjyshen dhe përvoja e saj me vaksinimin.

“Palimpsest III” is a reflection on memory and the way it shapes our perception of the world. Inspired by Martin Camaj’s book “Palimpsest”, the work addresses the idea that memories intertwine with time, creating new layers of meaning and emotion. At its center is a personal memory, where the artist’s grandmother would teach children to make paper boats to distract them from the pain of vaccination. This memory weaves together with other feelings, such as her relationship with her grandmother and her own experience of vaccination.

# ERGYS VELA

**Imitimi  
2025**

Ergys Vela rikthen temën e njohur të mimesis-it, pyetjen e hershme të artit si imitim. Ai e përqendron eksplorimin e tij te fjala shqipe imitimi — një term që, kur zbërthehet, zbulon kuptimin literal të imazhit-pasqyrë të ngulitur brenda saj. Kjo lojë gjuhësore bëhet një mjet konceptual: pasqyra jo thjesht si reflektim, por si një vend ku kuptimi përdridhet mbi vetveten. Në instalacionin e Velës, imitimi shtrihet përtej gjuhës për të zënë hapësirë. Vepra e paraqet imitimin si një qark të pafund, ku përsëritja nuk shërben më për të riprodhuar, por për të gjeneruar. Çdo jehonë, çdo rikthim, hap një ndryshim të imët, një zhvendosje në perceptim. Pasqyra nuk paraqitet si një sipërfaqe statike, por si një mekanizëm i shqetësuar i shndërrimit, që e tërheq shikuesin në ciklin e saj. Duke lidhur fjalën, imazhin dhe formën, Vela e shndërron imitimin në një forcë gjenerative, duke e kthyer një koncept të njohur në një fushë të hapur kërkimi vizual dhe filozofik.

Ergys Vela revisits the enduring theme of mimesis, the age-old question of art as imitation. He anchors his exploration in the Albanian word imitimi — a term that, when broken down, reveals the literal sense of the mirror-image embedded within it. This linguistic play becomes a conceptual tool: the mirror not just as reflection, but as a site where meaning folds back on itself.

In Vela's installation, imitimi expands beyond language to occupy space. The work stages imitation as an infinite loop, where repetition no longer serves to replicate but to generate. Each echo, each return, opens a subtle difference, a shift in perception. The mirror becomes not a static surface but a restless mechanism of becoming, pulling the viewer into its cycle.

By binding word, image, and form, Vela turns imitation into a generative force, transforming a familiar concept into an open field of visual and philosophical inquiry.

# ERJOLA ZHUKA

**MyTh-ing  
2022**

Veprat fotografike të Erjola Zhukës shpesh pasqyrojnë realitetin e përditshëm me një ton ironik, duke i ftuar shikuesit të vënë në diskutim kushtet e ekzistencës post-moderne. Duke mbivendosur imazhe dhe mesazhe që i rezistojnë interpretimit të kollajtë, praktika e saj sfidon si dekodifikimin e botës ashtu edhe aktin e të dëgjuarit të vetvetes, duke inkurajuar një rishqyrtim të rregullave shoqërore dhe çlirimin nga kufizimet e shoqërisë bashkëkohore. Përmes një qasjeje spontane, Zhuka kërkon të krijojë një hapësirë ku shikuesit ndihen të lirë të dorëzohen; ku harrojnë gjithçka dinë. Veprat e saj shpesh krijojnë një hapësirë të errët dhe të zbrazët ku mendimi nuk është më i kufizuar tek rregullat apo dukjet e qëruara.

Kjo hapësirë aspiron ta kthejë shikuesin në një gjendje primordiale, duke ia fshirë dijet dhe mitet, për t'i lënë vend shprehive të reja. Teksa shkrep fotografi të vendeve dhe njerëzve në periudha kalimtare, Zhuka reflekton mbi identitetet hibride ku gjurmët e Evropës Lindore bashkëjetojnë me simbolet e diktaturës dhe forcat e globalizimit.

The photographic works of Erjola Zhuka often mirror everyday reality with an ironic tone, inviting viewers to question the conditions of post-modern existence. By layering images and messages that resist easy interpretation, her practice challenges both the decoding of the world and the act of listening to oneself, encouraging a reconsideration of social conventions and liberation from the constraints of contemporary society. Through a spontaneous approach, Zhuka seeks to create a space where viewers feel free to surrender; as if forgetting everything they already know. Her works often generate a dark, empty space where thought is no longer bound by conventions or polished appearances. This space aspires to return the observer to a primordial state, erasing knowledge and myth in order to make room for new ones. Capturing territories and people in moments of transition, Zhuka reflects on hybrid identities where traces of Eastern Europe coexist with symbols of dictatorship and the forces of globalization.

# IVA LULASHI

**Ti ho pensata così, 2015**

**Nudo, non per te, 2016**

**Speravo fosse sole, 2017**

**Per l'insostenibilità dell'essere, 2018**

Pikturat e Iva Lulashit na shfaqin një hapësirë të pezulluar, ku trupat duken të bllokuar në një kufi që nuk merr kurrë zgjidhje- as përpara as prapa. Ato shfaqen si fragmente filmash apo kujtimesh të harruara, lakuriq jo nga ekzibicionizmi, por nën peshën e padurueshme të qenies. Në këtë atmosferë liminale, dëshira nuk bëhet e dukshme, por ndjesore: një prani që qëndron në zbrastë, midis sipërfaqeve, në gjeste kalimtare që kalojnë pa marrë kurrë formë. Çdo kanavacë mbart tensionin e një imazhi pa lëvizje që ngjan si i shkëputur nga rrjedha e kinemasë, dhe i kondensuar në qetësi. Megjithatë, brenda asaj qetësie diçka nxitet - një lëvizje e brendshme që sugjeron atë çfarë kish ndodhur më përpara dhe atë çka mund të vijë pas. Erotika, këtu, nuk kufizohet vetëm në figura ose akte, por depërton në çdo detaj, duke prishur ekuilibrin midis trupave, objekteve dhe sfondeve. Fotogramet e Lulashit vibrojnë me frekuenca malli, ndërhyrjeje dhe përçarjeje, duke na mbajtur në skajin e brishtë të zbulësës.

Iva Lulashi's paintings open onto a suspended space, where bodies appear caught on a threshold that never resolves—neither forward nor back. They emerge like fragments of forgotten films or memories, nude not out of exhibitionism but under the unbearable weight of being. In this liminal atmosphere, desire is not made visible, but sensed: a presence that lingers in the gaps, between surfaces, in fleeting gestures that brush past without ever taking form. Each canvas carries the tension of an image arrested in motion, as if plucked from the flow of cinema and condensed into stillness. Yet within that stillness something stirs—an internal movement that suggests both what came before and what might follow. The erotic, here, is not confined to figures or acts, but infiltrates every detail, disturbing the balance between bodies, objects, and backgrounds. Lulashi's frames vibrate with frequencies of longing, interference, and disruption, holding us at the fragile edge of revelation.

# JONA KRASNIQI

## The Rooms of Grand Hotel of Prishtina 2024

“The Rooms of Grand Hotel of Prishtina” nga Jona Krasniqi merret me përkohshmërinë e brishtë të hapësirave që mbajnë peshën e historisë. Një pishtar luksi, i inauguruar në vitin 1978, Grand Hoteli qëndron ende në zemër të Prishtinës. Muret e tij mbartin si gjurmët e luftës ashtu edhe vazhdimësinë e jetës. Krasniqi transferon fotografitë e saj në dru MDF, duke lejuar që sipërfaqja e materialit t’i “përgjigjet” vetë subjektit: gërvishtjet, teksturat e pabarabarta dhe relievi i bëjnë jehonë përkeqësimit të gjendjes së godinës të hotelit. Ajo që del në pah nuk është vetëm një imazh, por një kujtim prekës, një sipërfaqe e dyfishtë ku materia dhe historia konvergojnë. Puna e saj ndalet në të pavërejturën dhe të ndërmjetmen, ku mungesa rezonon po aq fort sa prania. Në këtë përkthim të fotografisë në objekt, artistja e riformulon hotelin si dëshmitar dhe protagonist - një vend ku rezistenca dhe brishtësia mbeten të ndërthurura në mënyrë të pandashme.

Jona Krasniqi’s “The Rooms of Grand Hotel of Prishtina” engages with the fragile temporality of spaces that bear the weight of history. Once a beacon of luxury when it opened in 1978, the Grand Hotel still stands in the heart of Prishtina, its walls carrying both the traces of war and the persistence of life. Krasniqi transfers her photographs onto MDF wood, allowing the surface of the material to “answer back” to the subject itself: the scratches, uneven textures, and relief echo the hotel’s physical deterioration. What emerges is not only an image but a tactile memory, a double surface where matter and history converge. Her work dwells on the unnoticed and the in-between, where absence resonates as strongly as presence. In this translation of photograph into object, the artist reframes the hotel as both witness and protagonist—a place where resilience and vulnerability remain inseparably intertwined.

# JOZEFINA VOKRRI

**The Innocence of Play  
2022**

Në këtë instalacion video me tre kanale, Jozefina Vokri ndërthur në kohë, fragmente nga fëmijëria. Ekranet e jashtme tregojnë fëmijët e sotëm duke luajtur në rrugë të zymta betoni - hapësira që duken pothuajse të pamundura për t'u shijuar, por që transformohen nëpërmjet shpikjes dhe dëshirës së tyre për lojë. Në qendër, një fragment nga fëmijëria e vetë artistes, dikur një video e rastësishme në shtëpi, tani mbart një rëndësi të beftë. Këtu, fëmijët imitojnë të rriturit me gjeste që ekspozojnë realitetet shoqërore të së kaluarës jo shumë të largët të Shqipërisë. Së bashku, të tre videot hapin një dialog midis së kaluarës dhe së tashmes. Nëpërmjet lojës së fëmijëve, secila video pasqyron në mënyrë të tërthortë sfidat e kohës së vet, duke formësuar si kujtesën personale ashtu edhe ndjenjën tonë kolektive të historisë.

In this three-channel video installation, Jozefina Vokri interweaves fragments of childhood across time. The outer screens show children today at play in stark, concrete streets—spaces that seem almost impossible to enjoy, yet are transformed through their inventiveness and desire for play. At the center, a fragment from the artist's own childhood, once a casual home video, now carries unexpected gravity. Here, children imitate adults in gestures that, in hindsight, expose the social realities of Albania's not-so-distant past. Together, the three videos open a dialogue between past and present. Through the lens of children's play, they reveal how resilience and imagination endure across generations, shaping both personal memory and our collective sense of history.



# LAURA PAJA

Lajmëtarët / The Messengers  
2021

Gjama e burrave është një vajtim i lashtë funeral nga veriu i Shqipërisë, i kënduar nga burrat për burrat, një ritual i një mashkullërie të theksuar ku figura femërore nuk ka vend. Megjithatë, brenda historisë së gjatë të traditës shqiptare, përjashtime nuk mund të përjashtohen plotësisht. Një nga këto përjashtime mund të gjendet te burrneshat, virgjëreshat e betuara: gra në margjina që, sipas Kanunit, merrnin një identitet mashkullor dhe detyrimet shoqërore që lidhen me të. Disa rrëfime gojore, edhe pse kurrë të konfirmuara, sugjerojnë se Gjama e burrave mund të jetë kënduar ndonjëherë për një burrneshë. Kjo mundësi e rrallë dhe e vështirë për t'u kapur bëhet çelësi interpretues i punës. Pyetja që lind është e thjeshtë dhe radikale: A mund një zë tjetër të banojë këtë këngë? Në “Lajmëtarët / The Messengers”, artistja huazon trupin e saj vokal për të thirrur një hidhërim që nuk i përket asaj. Arkitektura sonore e instalacionit fragmenton dhe ribën vajtimin, duke rishkruar ritualin mashkullor përmes një zëri që bëhet kor, trup kolektiv dhe mundësi historike.

Gjama e burrave (The Thunder of Men) is an ancient funeral lament from northern Albania, sung by men for men, a ritual of heightened masculinity in which the female figure has no place. Yet within the long history of Albanian tradition, exceptions cannot be entirely ruled out. One such exception may lie with the burrneshat, the sworn virgins: women on the margins who, according to the Kanun, assumed a male identity and its social obligations. Some oral accounts, though never confirmed, suggest that Gjama e burrave may once have been sung for a burrneshë. This rare and elusive possibility becomes the interpretive key of the work. The question that arises is both simple and radical: Can another voice inhabit this song? In “Lajmëtarët / The Messengers” the artist lends her vocal body to summon a grief not her own. The installation’s sonic architecture fragments and recomposes the lament, rewriting the masculine ritual through a voice that becomes chorus, collective body, and historical possibility.

# LORI LAKO

## Nationalism, you wild beast 2023

“Nationalism, you wild beast” lind nga një projekt bashkëpunimi midis artistes dhe artizanëve të tekstitit. Pikënisja është motivi i shqiponjës, i gjetur në flamurin kombëtar shqiptar, i cili zgjerohet në një grumbullim figurash kafshësh të marra nga flamujt e shteteve të ndryshme, përfshirë këtu edhe zogjtë dhe reptilët. Kompozimi, i thurur me dorë, në bardh e zi mbi një qilin tradicional, kontraston me natyrën digjitale të vetë imazhit. Kjo mbivendosje e mjeshtërisë së punëdorës të tekstitit dhe imazhit digjital, krijon një tension vizual që të kujton estetikën e lojërave të hershme kompjuterike, e karakterizuar nga fragmentimi dhe gabimet vizuale. Brenda imazhit, krijesat e nxjerra nga emblema të ndryshme kombëtare, bashkohen dhe mbivendosen, duke gjeneruar një kimerë hibride që i shmanget klasifikimit të thjeshtë. Në klimën politike të sotme, e shënuar nga rikthimi i ideologjive nacionaliste dhe fashiste dhe nga përcaktimet gjithnjë e më të ngurta të identitetit, kjo punë sfidon autoritetin e këtyre simboleve dhe kufijtë që ato imponojnë. Duke shpërbërë identitetet vizuale fikse në hibridë të paqartë, ajo ekspozon brishtësinë e narrativave nacionaliste dhe rreziqet që ato paraqesin.

“Nationalism, you wild beast” originated from a collaborative project between contemporary artist Lori Lako and textile artisans. Its point of departure is the eagle motif found on the Albanian national flag, which expands into an assemblage of animal figures sourced from the flags of various nation-states, including birds and reptiles. The composition, handwoven in black and white on a traditional kilim, stands in contrast to the digitally constructed nature of the image itself. This juxtaposition between the tactile craft of textile-making and the digital image produces a visual tension reminiscent of early video game aesthetics, characterized by fragmentation and glitches. Within the image, creatures derived from diverse national emblems merge and overlap, generating a hybrid chimera that defies straightforward classification. In today's political climate, marked by resurgent nationalist and fascist ideologies and increasingly rigid definitions of identity, the work unsettles the authority of these symbols and the borders they enforce. By dissolving fixed visual identities into ambiguous hybrids, it exposes the fragility of nationalist narratives and the dangers they pose.

## MARINA SULA

Untitled  
2025

Marina Sula punon me të zakonshmen: një kanaçe Coca-Cola, ekrani i një ore digjitale, i parë përmes xhamit të shtrembëruar. Të shtrira në vija horizontale, imazhet ngajnë si të shtrydhura, e banaliteti i tyre sikur na shfaq një të vërtetë tjetër. Ato të kujtojnë shkallën e një billboard-i, por me cilësinë aksidentale të një imazhi të kapur rastësisht. Copëza, sekuenca të fragmentarizuara që na e ngadalësojnë perceptimin - jehona procesesh teknike të manipulimit të pelikulës, ku identifikimi vjen nga flakërimet të befta: shkëlqimi i “C”-së të Coca-Cola, një vezullim që venitet si drita mbi ujë. Ngjyra e amplifikon këtë lojë. E kuqja dhe e bardha, e kuqja dhe e zeza, si dy anët e ruletës që rrotullohen në drejtime të kundërta, duke pezulluar kohën në tensionin e vendimarrjes. Imazhet bëhen më shumë sesa sipërfaqe: pasqyra të shtrira ku njohja rrëshqet, ku e njohura tretet në dyshim. Fotografia këtu është më shumë zhdukje sesa posedim, një sipërfaqe në venitje e sipër.

(Bazuar në një tekst nga Paolo Baggi)

Marina Sula works with the ordinary: a Coke can, the screen of a digital clock, seen through the distortion of glass. Stretched into horizontal stripes, the images look as if squeezed, their banality forced to yield some other truth. They recall the scale of a billboard, yet with the accidental quality of an image caught by chance. Fragmented and sequenced, they slow down perception—echoes of cinema’s step-printing, where recognition comes in fugitive flashes: the glimmer on the “C” of Coca-Cola, a shimmer that vanishes like light on water. Color amplifies this play. Red and white, red and black, like the two sides of roulette, circling in opposite directions, suspending time in the tension of decision. The images become more than surfaces: stretched mirrors where recognition slips, where the familiar dissolves into doubt. Photography here is less possession than disappearance, a surface always already fading. (Based on a text by Paolo Baggi)

# NORA BZHETA

**Flight mode**  
**2024**

“Flight mode” është një fotografi 16mm e printuar mbi letër muri, një vepër ku vetë lëvizja bëhet njëkohësisht subjekt dhe medium. Imazhi shpaloset si një sipërfaqe që ndryshon vazhdimisht mes kalimeve, ndalesave dhe kryqëzimeve, ku materialet dhe trupat shfaqen në marrëdhënie të fshehta, të kamufluara. Vepra reflekton mbi transformimin, i pasqyruar në palosjet, shtrirjet dhe shtresëzimet e formave. Ajo nënkupton infrastrukturën e padukshme që rregullojnë mobilitetin—pragjet burokratike dhe shoqërore që përcaktojnë mënyrën se si dikush lëviz—por pa i paraqitur drejtpërdrejt. Përkundrazi, fotografia e shtrirë mbi letër muri bëhet një fushë pezullie, një hapësirë ku ri-konfigurimi është gjithmonë në lojë. “Flight mode” është njëkohësisht kalim dhe regjistrim, që shënon territoret e brishta, të përkohshme, që hapen mes nisjes dhe mbërritjes.

“Flight mode” is a 16mm photograph printed on wallpaper, a work where movement itself becomes both subject and medium. The image unfolds as a shifting surface of passages, pauses, and crossings, where materials and bodies appear in subtle, camouflaged interrelations. The work reflects on transformation, mirrored in the folding, stretching, and layering of forms. It gestures toward the unseen infrastructures that govern mobility—the bureaucratic and social thresholds that shape how one moves—yet it does so without direct depiction. Instead, the wallpapered photograph becomes a field of suspension, a space where reconfiguration is constantly at play. Flight mode is both a crossing and a record, marking the fragile, ephemeral territories that open between departure and arrival.

# SAŠA TATIĆ

**The Visit  
2025**

“The Visit” bën pjesë në serinë e veprave murale të Saša Tatić, që i japin zë asaj që shpesh mbetet e pathënë. Çdo vepër përmban një frazë që artikulon të dukshmen, por në të njëjtën kohë e destabilizon atë, duke u luhatur mes sinqeritetit dhe ironisë. Këtu, fjalët “I visit home whenever I can” (Kthehem në shtëpi sa herë të mundem) janë të vendosura në murin hyrës të galerisë, të lexueshme për ata që afrohen e njëkohësisht të pezulluara mes intimitetit dhe largësisë. Shtëpia shfaqet si e afërt dhe e paarritshme, një vend kujtese, dëshire dhe kontradikte. E vendosur në hyrje, vepra fton vizitorët të qëndrojnë para saj, të pozojnë ose thjesht të ndalojnë, duke e banuar për një çast vetë frazën. Në këtë mënyrë, muri bëhet jo vetëm një sfond, por një skenë takimi, ku rrëfimet personale mbivendosen me tekstin. “The Visit” shpaloset si një arkitekturë njohjeje dhe tëhuajësimi, ku humori dhe reflektimi bashkëjetojnë në hapësirën e përbashkët të mbërritjes.

“The Visit” is part of Saša Tatić’s ongoing series of wall-based works that give voice to what is often left unsoken. Each piece features a phrase that articulates the obvious while at the same time destabilizing it, shifting between sincerity and irony. Here, the words “I visit home whenever I can” extend across the wall at the gallery’s entrance, legible to those approaching, suspended between intimacy and distance. Home emerges as both near and unreachable, a place of memory, longing, and contradiction. Positioned at the threshold, the work invites visitors to step in front of it, to pose or linger, momentarily inhabiting the phrase. In this way, the wall becomes not just a backdrop but a stage of encounter, where personal stories overlap with the text. “The Visit” unfolds as an architecture of recognition and estrangement, where humor and reflection coexist in the shared space of arrival.

# XHULIAN MILLAJ

**Resorts of Solitude  
2020**

Në këtë cikël, bregdeti i Velipojës është njëkohësisht subjekt dhe metaforë. Të nxjerra nga Google Street View rreth vitit 2016, katër vite para shembjes së ndërtesave të paligjshme buzë detit, imazhet digjitale transformohen në piktura analoge, duke përthithur një moment tensioni midis qëndrueshmërisë dhe përkohësisë. Strukturat në shkatërrim, dikur sfiduese dhe të ngritura pa kriter, tani janë kthyer në “rërë”, fshirësi i qetë i natyrës dhe masa më intime e kohës. Në këto vepra, ndërtesat shërbejnë si arkitektura emocionale: të ngritura me ngut, të brishta dhe thellësisht njerëzore. Rëra, gjithmonë në lëvizje, vepron si dëshmitare dhe forcë, duke gëlltitur gradualisht këto ndjesi, në procesionin e saj granular. Dalëngadalë shfaqen dy paralele: ndërtesat dhe ndjesitë, rëra dhe koha. Ky është një meditim mbi kotësinë e rezistencës ndaj erozionit, material apo emocional, dhe dinjitetin e qetë të shembjes. Kalimi nga imazhi digjital në pikturë bëhet një formë e përkthimit të kohës. Duke kthyer regjistrime virtuale dhe automatike në vepra të prekshme dhe interpretative, projekti eksploron peizazhin në ndryshim, si hapësirë e si kujtesë. Ky akt transformimi mediatik bëhet një gjest rivendosjeje, duke ngadalësuar shikimin e pavetëdijshtëm, për të rikthyer atë që është humbur, jo më si e dhënë, por si prani.

In this cycle, the coast of Velipoja becomes both subject and metaphor. Extracted from the lens of Google Street View circa 2016, four years before the collapse of illegal seaside buildings, these digital snapshots are transformed into analogue paintings, distilling a moment of tension between permanence and impermanence. The crumbling structures, once defiant and misplaced, now turned to “sand”, nature’s quiet eraser and time’s most intimate measure. In these works, buildings become stand-ins for emotional architecture: hastily erected, fragile, and deeply human. The sand, ever shifting, acts as both witness and force, gradually swallowing these feelings in its granular procession. Two parallels emerge: buildings and feelings, sand and time. This is a meditation on the futility of resisting erosion whether material or emotional and the quiet dignity in collapse. The shift from digital image to painting becomes a form of temporal translation. By converting virtual, automated records into tactile, interpretive artworks, the project navigates the changing landscape not only in space but in memory. This act of media transformation becomes a gesture of reclamation, slowing down the automated gaze to reframe what was lost, not as data, but as presence.

# MARUBI NATIONAL MUSEUM OF PHOTOGRAPHY

# ELTON GLLAVA

**Solaris**  
**2020**

“Solaris” është një shikim i ngulitur në pasqyrë, që nuk mund ta shmangësh më. Me këtë vepër fotografike, artisti Elton Gllava na kthen në të kaluarën e afërt, kohën e pezulluar të pandemisë Covid. Nga prania në mungesë, ky është një udhëtim nëpër errësirën e brendshme. Gjatë atyre muajve të heshtur, koha ndryshoi ritmin e saj. Orët shtriheshin si hije dhe çdo ditë bëhej një pasqyrim i vetvetes. Frika lëvizte dalëngadalë nëpër dhoma, jo frika nga virusi, por nga humbja e diçkaje dikur të dashur, që largohet pa fjalë. Një person që njëkohë rrezatonte dritë mbi trupin tënd, të bëhet një i huaj. Afërsia shndërrohet në boshllëk, ndjenjat në fotografi të zbehura. Kjo vepër lindi në atë hapësirë të thyer, ku humbja përsëritej çdo ditë, si një ritual që të asgjëson. “Solaris” reflekton si oqeani i huaj, në filmin fotografik: nuk jep përgjigje, por të detyron të përballesh me atë që e doje, e humbe dhe që nuk do të kthehet kurrë më.

“Solaris” is a long gaze into the mirror you can no longer avoid. With this photographic work, artist Elton Gllava takes us back to the recent past, the suspended time of the Covid pandemic. From presence to absence, it is a journey through the darkness within. During those silent months, time altered its rhythm. Hours stretched like shadows, and each day became a reflection of the inner self. Fear moved slowly through the rooms, not fear of the virus, but of losing something once loved, slipping away without words. A person who was once light in your body becomes a stranger. Closeness turns into emptiness, feelings into faded photographs. This work was born in that broken space, where loss repeated itself daily, like a ritual erasing you. Solaris reflects like the alien ocean in the film: it gives no answers, but forces you to face what you loved, lost, and will never return.



# ERDIOLA KANDA MUSTAFAJ

**Island of Time  
2022-2025**

I përbërë nga imazhe fragmentare, të shkrepura në gjashtë vitet e fundit midis Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë, projekti shqyrton se si kujtesa ruhet, fshihet ose riaktivizohet ndër breza, në lëvizje të përhershme përmes gjeografive të ndryshme. Atmosfera sublime shfaqen dhe zbehen; vende të caktuara transformohen, ndërsa të tjera zbulojnë rituale që ekspozojnë tensionet brenda peizazhit, duke tërhequr vëmendjen te rëndësia e diasporës dhe ndikimi i saj. Të gjitha së bashku ndërtojnë një arkeologji të mërgimit. Mërgimi, një figurë e shkëputur dhe e pakapshme, i shpëton koordinatave të kohës; i paharmonishëm, i çrrënjësuar nga tokat e të parëve, duke mishëruar një kujtesë të shpërngulur. Ai hap një hapësirë nga ku buron miti, i pezulluar midis së vërtetës dhe shtrembërimit. Vetë kujtesa bëhet një sarkofag, nga e cila shpërthejnë forma amorfe, duke shqyer strukturën e së dukshmes. Këto fragmente grumbullohen si utopi të jetuara dhe të ritreguara një mijë herë; hije që dalin në breg, në detin e kujtesës, si rrënojat e një anijeje.

Composed of fragmentary images, taken over the past six years between Albania, Greece, and Italy, the project interrogates how memory is preserved, erased, or reactivated across generations in perpetual motion through disparate geographies. Sublime atmospheres appear and fade; certain places are transfigured, while others reveal rituals that expose tensions within the landscape, drawing attention to the significance of diaspora and its impact, building together an archeology of the exile. Exile, a detached and elusive figure, escapes the coordinates of time; always out of sync, cast away from ancestral lands, embodying a displaced memory. It opens a space for myth to emerge, suspended between truth and distortion. Memory itself becomes a sarcophagus, from which amorphous forms erupt, tearing open the fabric of the visible. These fragments accumulate as utopias lived and retold a thousand times; shadows that wash ashore on the beach of remembrance like the wreckage of a ship.

# JETMIR IDRIZI

**Museum of Bad Memories  
2011**

Në serinë e tij fotografike “Muzeu i Kujtimeve të Këqija”, Jetmir Idrizi e kthen objektivin nga Spaçi, ish-burgu politik ku regjimi komunist në Shqipëri izoloj disidentët për më shumë se dyzet vjet. Përmes portreteve të të mbijetuarve dhe fotografive të objekteve, dokumenteve dhe kujtimeve të tyre, ai mbledh një arkiv të brishtë rezistence. Kjo seri punimesh buron nga takimet me ish-të burgosur dhe të mbijetuar të kampeve të punës, historitë e të cilëve i rezistojnë harresës. Në vitin 2009, pati propozime për ta shndërruar Spaçin në muze, por ende sot, e ardhmja e tij mbetet e pasigurt. Fotografitë e Idrizit ofrojnë një hapësirë kujtese dhe reflektimi, duke vepruar si gjurmë të qëndrueshme të dinjitetit njerëzor kundër makinerisë së shtypjes.

In his photographic series “Museum of Bad Memories”, Jetmir Idrizi turns his lens toward Spaç, former political prison where Albania’s communist regime confined dissent for over forty years. Through portraits of survivors and photographs of their objects, documents, and memories, he assembles a fragile archive of resistance. This body of work emerged from encounters with former prisoners and survivors of labour camps, whose stories resist erasure. In 2009, proposals surfaced to transform Spaç into a museum, yet its future remains uncertain. Idrizi’s photographs offer a space of remembrance and reflection, acting as enduring traces of human dignity against the machinery of repression.

# ORESTIA KAPIDANI

**Milk and Blood, 2004**  
**Un-Seen, 2020**

Puna e Orestia Kapidanit lëviz mes qartësisë solemne të portretit të pozicionuar dhe territoreve të pasigurta të ëndrrës. Në “Milk and Blood”, individët qëndrojnë ballë për ballë me objektivin, plotësisht të vetëdijshëm se po fotografohen. Ky çast duket i shkëputur nga jeta e përditshme, i mbushur me të njëjtën gravitet festiv si pjesëmarrja në meshë, moment gjatë të cilit këto fotografi u realizuan. Pas tyre shtrihet një sfond: një imazh i zmadhuar i studios historike Marubi, që paraqet një urë që lidh malet me qytetin. Si skenografitë e pikturuara të shekullit XIX, ajo i ndan subjektet e portretizuara nga çka i rrethon, duke u siguruar që asgjë të mos i shpërqendrojë. Shikimet e tyre, të ngulitura dhe të drejtpërdrejta, e ballafaqojnë shikuesin me një prani të patundur. Në “Un-Seen” regjistri ndryshon. Si në ëndrra, imazhet mjegullohen dhe errësohen, të ndriçuara vetëm nga detaje të vogla e të pakapshme. Prania dhe mungesa shkrihen me njëra-tjetrën, dhe identitetet treten, duke sugjeruar se imazhi fotografik nuk përkon kurrë plotësisht me realitetin.

Orestia Kapidani's work moves between the solemn clarity of the posed portrait and the uncertain territories of the dream. In “Milk and Blood”, the individuals stand frontally before the lens, fully aware of being photographed. The moment feels detached from daily life, imbued with the same festive gravity as attending church, when the photographs were taken. Behind them stretches a backdrop: an enlarged image from the historic Marubi Studio, showing a bridge that links mountain and city. Like the painted studio sceneries of the 19th century, it separates the portrayed subjects from their surroundings, ensuring that nothing distracts from them. Their gazes, fixed and direct, confront the viewer with an unyielding presence. In “Un-Seen”, the register shifts. Like dreams, the images blur and darken, lit only by small, elusive details. Presence and absence merge, and identities dissolve into one another, suggesting that the photographic image may never coincide with reality.

# SILVA AGOSTINI

**Portrayal of a Crisis  
2019**

“Portrayal of a Crisis” reflekton mbi ndjeshmërinë njerëzore dhe natyrën e përkohshme të ekzistencës. E vendosur në marrëdhënie me vende historike dhe fetare, vepra eksploron dinamikat e ndërthurura të kërcënimit dhe të mbrojtjes që kanë shoqëruar prej kohësh, jetën e njeriut. Përmes kësaj lenteje, e shkuara nuk zhduket kurrë plotësisht, por mbetet e shtresëzuar brenda formave kulturore që modelojnë përditshmërinë tonë. Duke u mbështetur në arkitekturën urbane, praktikat teatrale dhe performative—përfshirë këtu opera, teatër, akrobaci dhe stand-up comedy—përveç fotografisë, videos dhe instalacioneve në hapësirë—artistja shqyrton mënyrën se si vazhdimësia kohore formëson kuptimin e të qenurit. Praktikë tradicionale dhe fetare ndërthuren me shprehje bashkëkohore, duke krijuar një dialog midis kujtesës dhe menjëhershmerisë, të shkuarës dhe të tashmes. Vepra nxjerr në pah fluiditetin e ekzistencës njerëzore, duke theksuar tensionin e vazhdueshëm midis stabilitetit dhe përkohësisë, dhe fton për reflektim mbi mënyrën se si ballafaqohemi me cënueshmërinë, kujtesën dhe trashëgiminë kulturore.

“Portrayal of a Crisis” reflects on human vulnerability and the fleeting nature of existence. Situated in relation to historical and religious sites, the work explores the intertwined dynamics of threat and protection that have long accompanied human life. Through this lens, the past is never fully gone but persists, layered within the cultural forms that shape our everyday present. Drawing on urban architecture, theatrical and performative practices—including opera, theater, acrobatics, and stand-up comedy—alongside photography, video, and site-specific installation, the artist investigates how temporal continuity frames our understanding of being. Traditional and religious practices intersect with contemporary expression, creating a dialogue between memory and immediacy, past and present. The work evokes the fluidity of human existence, emphasizing the ongoing tension between stability and impermanence. It invites reflection on how we navigate vulnerability, memory, and cultural inheritance, revealing the ever-shifting contours of life, and the subtle ways in which history, ritual, and performance shape our perception of the present.

# STEFANO ROMANO

**Study for a monument  
2014 – ongoing project**

Monumenti ka qenë gjithmonë diçka e “imponuar” nga lart, duke i treguar popullit cilat vlera duhen respektuar. Ky projekt zhvillohet si një arkiv fotografik që, duke reflektuar mbi rëndësinë bashkëkohore të monumenteve, synon të marrë tjetër drejtim. Artisti shëtit nëpër qytete me një shkallë të vogël të kuqe dhe i kërkon njerëzve që takon, të marrin pjesë në projekt dhe të “performojnë” idenë e tyre për një monument. Pjesëmarrësit jo vetëm që shprehin idenë që duan të transmetojnë, por zgjedhin edhe vendin e fotografimit si dhe titullin e “skulpturë” së tyre personale. Fotografitë që dokumentojnë këto performanca përfaqësojnë secila një ide, një vlerë, një kujtim — dhe kështu një lloj studimi — mbi konceptin e monumentit, formën, ngjyrën dhe të gjitha vlerat estetike dhe etike që e përbëjnë atë. Për këtë ekspozitë, Romano prezanton një seri të re fotografike, e realizuar kësaj radhe në Shkodër, në marrëdhënie me rrugët, arkitekturën dhe komunitetet lokale të qytetit.

The monument has always been something “imposed” from above, showing the people which values they were expected to follow. This project develops as a photographic archive that, by reflecting on the contemporary relevance of monuments, seeks to reverse that direction. The artist walks through cities with a small red step ladder, asking people he meets to take part in the project and to “perform” their own idea of a monument. Participants not only express the idea they want to convey, but also choose the location for the photograph and the title of their personal “sculpture.” The photographs documenting these performances each represent an idea, a value, a memory — and thus a kind of study — on the concept of the monument, on form, on color, and on all the aesthetic and ethical values that constitute it. For this exhibition, Romano presents a new series of the work shot specifically in Shkodra, engaging directly with the city’s streets, architecture, and local communities.



# FRANCISCAN AUDITORIUM

# EDSON LULI

## Footsteps Towards the Future 2023

Në “Footsteps Towards the Future”, Edson Luli transformon një vizion distopik në një hapësirë çuditërisht të njohur. Rëra e ngrohtë nën këmbët tona dhe dritat e buta ngjallin një ndjesi déjà vu-je, sikur të kujtojnë një vend që dikur e njihnim. Jemi të ftuar të ecim nëpër të, duke lënë gjurmën tonë. Megjithatë, duke e parë nga afër, “dritat” janë shishe plastike të ngulura në rërë e të mbledhura në shkretëtirën e pesë kontinenteve. Ky ndryshim delikat na kthen përsëri në realitetin e zyrtar: marrëdhënien tonë të përbashkët dhe të brishtë me planetin dhe të vërtetën urgjente dhe të pashmangshme të krizës klimatike.

In “Footsteps Towards the Future”, Edson Luli transforms a dystopian vision into a strangely familiar space. Warm sand beneath our feet and soft, atmospheric lights evoke a sense of déjà vu, as if recalling a place we once knew. We are invited to walk through it, leaving our own imprint. Yet, on closer inspection, the “lights” are plastic bottles embedded in the sand; gathered from deserts across five continents. This subtle shift draws us back to the stark reality: our shared, fragile interconnection with the planet and the urgent, inescapable truth of the climate crisis.



# OLD PACI HOUSE

# REMIJON PRONJA

**Wavelengths**  
2019

“Wavelengths” është një instalacion video që kthen kujtesën në dritë. Ai rrëfen historinë e një burri—Abedin Beqir Destani—përmes zërave të familjes së tij, ku kujtimi nuk është kurrë i ngulitur. Nipërit dhe djali flasin për të. Çdo dëshmi ndërthuret, përplasjet dhe shpërndahet, herë e mitizuar e herë e pakapshme. Historia lëviz midis pranisë dhe mungesës, lidhjeve Skype dhe dhomave të përbashkëta, hapësirave intime dhe të ndërmjetësuar. Instalacioni vizualizon pikërisht këto luhajtje: një neon i madh i modifikuar ndryshon dritë, ndriçon e zbehet. Drita dhe shkëlqimi i tij kontrollohen nga intensiteti i të folurit. Çdo fjalë, pushim dhe ngarkesë emocionale shndërrohet në valë dritë, që gjurmon pulsën e kujtesës. Kujtesa përkthehet në ritme elektrike, gjurmë spektrale të asaj që thuhet, mbahet mend ose harrohet. Këtu, akti i tregimit është gjithashtu një akt transformimi: narrativat familjare bëhen dritë, e përkohshme por materiale, duke shënuar paqëndrueshmërinë e kujtesës dhe mënyrat delikate me të cilat përpiqemi të mbajmë jetën në transmetim.

“Wavelengths” is a video installation that transforms memory into light. It tells the story of a man—Abedin Beqir Destani—through the voices of his family, where recollection is never fixed. Grandchildren and a son recount him, sometimes mythologized, sometimes elusive, each testimony layering, overlapping, diverging. The story moves between presence and absence, Skype connections and shared rooms, intimate and mediated spaces. The installation visualizes these fluctuations: a large, altered neon shifts in graded light, its brightness governed by the intensity of speech. Every word, pause, and emotional swell becomes a modulation, a visible wavelength tracing the pulse of remembrance. Memory is translated into electrical rhythms, a spectral trace of what is said, remembered, or forgotten. Here, the act of storytelling is also an act of transformation: family narratives become light, ephemeral yet material, mapping the instability of memory and the fragile ways we try to hold a life in transmission.

# RADIO SHKODRA

# ABI SHEHU

**Saharaja  
2021**

“Saharaja” e Abi Shehut është një video-instalacion që përdor pesëmbëdhjetë televizorë të vjetër të vendosur njëri mbi tjetrin në tre rreshta, që shfaqin në ekran, secili, nga një animacion që përsëritet vazhdimisht. Këto animacione burojnë nga imazhe fotografike të grafitëve (vizatime, shkrime dhe shenja) të gjendura në muret e rrënuara të ish burgut dhe kampit famëkeq të punës së Spaçit (1968-1990). Në gjendje të dobët fizike për shkak të mos ruajtjes, grafitet shërbejnë si gjurmë arkeologjike, duke dokumentuar praninë dhe vuajtjet e të burgosurve. Me sa duket i përkasin viteve të fundit të funksionimit të burgut (1987-1990) dhe arrijnë të transmetojnë një lloj aure ekzistenciale duke na futur në psikën dhe imagjinatën e të burgosurve që i mbijetojnë kushteve brutale. Përtej vlerës së tyre historike dhe antropologjike, ato mishërojnë estetikën e grafitëve të gjendura rëndom në vitet 1980-90, shpesh të krijuara në mjedise të mbyllura institucionale. Imazhet, të mbushura me stereotipe televizive, i bëjnë jehonë temave të seksit, reklamës, sportit dhe ideologjisë. Duke përdorur televizorë të vjetër, jo pak të adhuruar prej shqiptarëve, Shehu nxjerr në pah si joshjen nga transmetimet e huaja ashtu edhe reflektimet e brendshme të të burgosurve, duke u përpjekur të na shkundë sado pak dhe të na bëjë të kthejmë shikimin nga ato.

(Bazuar në tekstin e Alban Hajdinajt)

Abi Shehu's “Saharaja” is a video installation using twelve old television sets arranged in three rows, each displaying recurring animations. These animations derive from photographic images of graffiti, including drawings, writings, and signs, found on the deteriorating walls of the infamous Spaç prison and labor camp (1968 to 1990). Although in poor condition, the graffiti serve as archeological traces, documenting the presence and suffering of prisoners. Likely from the prison's final years (1987 to 1990), the graffiti convey a haunting existential aura and reflect the imagination of inmates enduring brutal conditions. Beyond their historical and anthropological value, they embody the aesthetics of public graffiti common in the 1980s, often shaped by closed institutional environments. The images, filled with television stereotypes, echo themes of sex, advertising, sports, and ideology. By using old televisions, objects once cherished in Albania, Shehu highlights both the allure of foreign broadcasts and the prisoners' inner reflections, reminding us of voices still striving to be seen.

(Based on the text by Alban Hajdinajt)

# HAVEIT COLLECTIVE

**The Red Thin Line**  
**2019**  
**2025**

E publikuar për herë të parë më 8 Mars 2019 - Dita Ndërkombëtare e Gruas – “The Red Thin Line” është një performancë video që përballet me mungesën e një linje telefonike të dedikuar, për viktimat e dhunës në familje në Kosovë. Sipas Amnesty International, dhuna në familje mbetet një problem i përhapur: midis korrikut 2023 dhe qershorit 2024, Kosova regjistroi 2,856 raste, me 79% të viktimave gra. Vetëm në vitin 2024, mbi 2,000 gra u raportuan si viktimat, duke reflektuar si rritjen e ndërgjegjësimit nga njëra anë, ashtu edhe kanosjen e vazhdueshme nga ana tjetër. Vepra është ripërfomuar brenda ndërtesës historike të Radio Shkodrës, duke amplifikuar simbolikisht zërat e të mbijetuarve dhe urgjencën e një reagimi sistemik, ndërsa na nxit ne si qytetarë të ndërmarrim veprime konkrete.

Originally released on March 8th, 2019—International Women’s Day “The Red Thin Line” is a video performance confronting the absence of a dedicated telephone hotline for domestic violence victims in Kosovo. According to Amnesty International, domestic violence remains a pervasive issue: between July 2023 and June 2024, Kosovo recorded 2,856 cases, with 79% of victims being women. In 2024 alone, over 2,000 women were reported as victims, reflecting both rising awareness and enduring vulnerability. The work is re-enacted inside the historic Radio Shkodër building, symbolically amplifying the voices of survivors and the urgency of systemic response, while urging us as citizens to take action.

# LEK M. GJELOSHI

**The real people went away  
2018-ongoing**

“The real people went away” vjen si një dhuratë: disa filma rul të ekspozuar dhe të dorëzuar artistit, pa asnjë të dhënë. Përmbajtja e tyre përbën një enigmë që në zanafillë: murgesha që ecin nëpër dëborë, trupa të ndalur në mes të një gjesti, peizazhe të shënjuara, a thua të ketë ndodhur një katastrofë. Imazhe që dukeshin sikur vinin nga një vend tjetër, gjysmë të harruara. Lek M. Gjeloşi e përqafton këtë errësi. Me një lexues të vjetëruar për negativë 35mm dhe lente të një smartphone-i, filmi i nënshtrohet një inversioni të dyfishtë: një negativ i dytë që e kthen mungesën në një vegim blu-cian. Çka lind nga ky proces nuk është një restaurim, por një hapësirë e transformuar, ku imazhet nuk dokumentojnë, por rrinë pezull. Këto fotografi i rezistojnë sigurisë, mbartin gjurmë të jetëve që mund të imagjinohen, por jo të rikthehen, duke insistuar se vetë zbrazëtira është pjesë e imazhit. (Bazuar në një tekst nga Amy Zion)

“The real people went away” begins with a gift: a few rolls of exposed film, handed to the artist without a frame of reference. What appeared on them was already an enigma: nuns crossing a white expanse of snow, bodies halted mid-gesture, landscapes marked as if by catastrophe. Images that seemed to arrive from somewhere else, half-forgotten. Lek M. Gjeloşi leans into this opacity. With an obsolete viewer for 35mm negatives and the lens of a smartphone, he subjects the film to a double inversion: a second negative that turns absence into a cyan-blue apparition. What emerges is not restoration but a transfigured space, where the images no longer document but hover. These photographs resist certainty, bearing traces of lives that can be imagined but not reclaimed, insisting that the void itself is part of the image. (Based on the text by Amy Zion)

# LUKA CVETKOVICH

**The One**  
2019

“The One” është performanca e një puthjeje të shumëpritur, por që nuk ndodh kurrë, duke shërbyer si metaforë për largësinë midis dy vendeve dhe dy popujve. Ajo eksploron prekjen si një shqisë që vjen para të tjerave: pa u prekur, nuk mund të kuptohet vetja (një) apo tjetri (dy), dhe nuk do të kishte as matematikë e as pozicione fikse. Vepra ndërthuret mes realitetit dhe fantazisë për të sfiduar konceptet e ngurta—besimin në një “Një” të vetëm, një zgjidhje të vetme, një përgjigje të qartë, apo ndarjen e prerë midis të drejtës dhe të gabuarës, të mirës dhe të keqes — duke sfiduar dëshirën për siguri në mënyrën se si lidhemi me të tjerët dhe me botën.

“The One” is a performance of an expected but never delivered kiss, serving as a metaphor for distance between two countries and two peoples. It explores touch as a sense prior to all others: without being touched, one could not form an understanding of oneself (one) or the other (two), and there would be no mathematics, no fixed positions. The work intertwines reality and fiction to question rigid concepts—the belief in a singular “One,” a single solution, a clear answer, or the sharp division between right and wrong, good and evil—challenging the desire for certainty in how we relate to others and the world.

# MARLIN DEDAJ

**Montestella  
2018**

Montestella është një kodër në Milano, e krijuar pas Luftës së Dytë Botërore nga rrënojat e ndërtesave të bombarduara dhe shembjeve, dhe më vonë e shndërruar në një park publik. Ajo shërben si skenë për serinë fotografike disavje çare të Marlin Dedajt, e cila reflekton mbi mënyrën se si vende të tilla shndërrohen në hapësira takimi dhe pranie të bashkëndarë. Në këtë imazh, tre të rinj janë ulur së bashku përballë horizontit, ndërsa pozicionet e tyre lëkunden mes intimitetit dhe shkëputjes. Një figurë qëndron paksa mënjanë, e tërhequr dhe vëzhguese, ndërsa dy të tjerët mbështeten te njëri-tjetri në një përqafim të përmbajtur. Shprehitë e tyre janë të palëvizura, pothuajse të pezulluara, sikur të bartin histori të pathëna. Praktika e Dedajt punon vazhdimisht në këtë regjistër: e vëmendshme ndaj gjesteve të vogla, ndaj dinjitetit të qetësisë, ndaj ndërthurjeve të heshtura mes hapësirës publike dhe emocioneve personale.

Montestella is a hill in Milan, created in the aftermath of World War II from the rubble of bombed buildings and demolitions, and later transformed into a public park. It is the setting of Marlin Dedaj's long-term photographic series, which reflects on how such places become sites of encounter and shared presence. In this image, three young people sit together against the skyline, their arrangement oscillating between intimacy and detachment. One figure sits slightly apart, composed and watchful, while the other two lean into one another in a restrained embrace. Their expressions are steady, almost suspended, as if carrying stories that remain unspoken. Dedaj's practice consistently works in this register: attentive to small gestures, to the dignity of stillness, to the quiet intersections of public space and private emotion.



# HOMEWARD

## 13.09.2025 - 13.10.2025

**Një ekspozitë nga** / An exhibition by  
Fondacioni “Art House” / Art House  
Foundation

**Kuruar nga** / Curated by  
Luçjan Bedeni, Tea Paci, Zef Paci, Niovi  
Zarampouka-Chatzimanou

**Në bashkëpunim me** /  
In collaboration with  
Galeria e Arteve e Shkodrës / Civic  
Gallery of Shkodër  
Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi” /  
Marubi National Museum of Photography  
Radio Shkodra  
Auditori françeskan / Franciscan  
Auditorium

**Prodhuar nga** / Produced By  
Kube Studios

**Dizajn i Ekspozitës & Instalimi** /  
Exhibition Design & Installation  
Kube Studios

**Koordinatorë e ekspozitës** /  
Exhibition coordinator  
Tereza Çuni

**Përkthimi** / Translation  
Tereza Çuni

**Redaktore** / Proofreader  
Melisa Ballata

**Projekti grafik** / Graphic Design  
Sindi Karaj

**Mikpritja** / Hospitality  
Melisa Ballata

**Asistente financiare** / Finance assistant  
Arvina Dibra

**Printimi i veprave fotografike** /  
Fine Art Print  
Dritan Mero

**Mediat Sociale** / Social Medias  
Blerina Kanxha

**Asistentë Produksioni**  
Production Assistants  
Edinjo Jahja  
Astrit Sula

**Support Teknik** / Technical Support  
Arenc Kasharaj

**Shtypi** / Print  
Shtypshkronja “Shkodra”  
Shkodra Design

## Sponsorizuar / Sponsors

Ministry of Economy, Culture and Innovation (MEKI)

Delegation of the European Union to Albania

International Cultural Weeks

Embassy of the Federal Republic of Germany

Istituto Italiano di Cultura di Tirana

Goethe Zentrum

Albanian Radio and Television

University of Shkodër “Luigj Gurakuqi”

Municipality of Shkodër

MiramART

Mrizi i Zanave

Produced by



In Collaboration With

ART HOUSE

MUZEU  
KOMBETAR I  
FOTOGRAFI  
MARUBI



Sponsors



CAN WE NOW IMAGINE  
THE NEXT TEN YEARS?

ART HOUSE